



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština – Municipality of Prishtina**

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 45, paragrafi 45.2 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, dhe të nenit 4, pika 4.3 e Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjes dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa të Kryeqytetit,

**th ë r r e t**

mbledhjen e katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **22.05.2023** dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën nr. 37 (kati II) të Komunës së Prishtinës.

Për mbledhje propozon këtë

**REND TË DITËS:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimi i Projektstatutit të Poliklinikës Stomatologjike;
3. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të volejbollit "Prishtina" – femrat;
4. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të basketbollit "Sigal Prishtina";
5. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të basketbollit të femrave "Prishtina";
6. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të futsalit – FC "Prishtina Futsal 01";
7. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të hendbollit - femrat KHF "Prishtina 1957";
8. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të hendbollit "Prishtina" – meshkujt;

9. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare klubit të volejbollit “Prishtina”;
10. Raporti vjetor i punës për vitin 2022 i ndërmarrjes publike “Kuzhina Qendrore”, SHA;
11. Raporti vjetor i punës për vitin 2022 i ndërmarrjes publike “ Prishtina Parking”, SHA;
12. Raporti vjetor i punës për vitin 2022 i ndërmarrjes publike “Hortikultura”, SHA;
13. Të ndryshme.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-060/01-93511/23, më 10.05.2023

**KRYESUESI I KOMITETIT**  
Fehmi Kupina

